

URDHËRI I MJEKËVE TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

RREGULLORE
PËR
GJYKIMIN DISIPLINOR PROFESIONAL

PJESA E PARË PËRKUFIZIME DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Bazimi dhe objekti

1. Gjykimi Disiplinor Profesional dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional janë bazuar në Ligjin Nr. 123/2014, datë 25.09.2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe në Statutin e U.M.SH.-së.
2. Mbështetur në këto akte normative, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë (U.M.SH.) ndërmer veprime dhe bën gjykimin disiplinor profesional të anëtarit të vet në rastet kur:
 - a. Kompetenca apo performanca profesionale e tij ka mangësi serioze.
 - b. Ka një akuzë për mjekim të pakujdesshëm apo sjellje profesionale të padenjë.
 - c. Është dënuar nga organet e drejtësisë.
 - d. Për shkak të gjendjes së tij shëndetësore bëhet i paaftë dhe i papërgjegjshëm për të ushtruar profesionin.
 - e. Veprimet dhe sjellja e tij përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe të legjislacionit në fuqi.

Neni 2 Qëllimi

1. Hartimi dhe miratimi i kësaj rregullore ka si qëllim :
 - a. Të vendos parimet dhe rregullat bazë për të siguruar një gjykim disiplinor objektiv të drejtë dhe të paanëshëm.
 - b. Të mbrojë anëtarin e Urdhrit nga një ndëshkim arbitrar dhe të pa merituar.
 - c. Nëpërmjet gjykimit disiplinor, bazuar në ankesat/denoncimet e mbërritura në Urdhër të evidentojë kundërvajtjet (që përbëjnë mjekim të pakujdesshëm) si dhe gabimet mjekësore me qëllim parandalimin e përsëritjes së tyre në praktikën mjekësore, në mbrojtje të shëndetit të pacientit dhe të publikut.

Neni 3 Parime të përgjithshme

1. Gjykimi Disiplinor Profesional është i pavarur, i paanshëm, objektiv dhe i drejtë.
2. Të gjitha ankesat e mbërritura në Urdhrin e Mjekëve, pa përjashtim regjistrohen në regjistrin e ankesave dhe i nënshtrohen shqyrtimit në Këshillin Rajonal përkatës.

3. I nënshtrohen verifikimit paraprak vetëm ankesat me shkrim, sipas formatit “A” që i bashkangjitet kësaj rregulloreje, dhe të firmosura nga ankuesi, i cili duhet të shënojë numrin e kontaktit dhe adresën e plotë të tij.
4. Urdhri i Mjekëve pranon dhe ndërmerr veprime disiplinore vetëm për çështje që i përkasin atributëve të tij të ligjshme, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit duke i ballafaquar ata me aktet normative në fuqi (ligje, kodi, statutin, vendime, etj).
5. Gjykimet në seancën dëgjimore dhe në Komisionin Disiplinor i nënshtrohen të gjitha çështjet e ankimuar, me përjashtim të atyre kur palët mirëkuptohen dhe me vullnetin e tyre bien dakort për mbylljen e çështjes.
6. Palët në gjykim kanë të drejtë të asistohen për mbrojtje ose të përfaqësohen në gjykim nga një person, të cilin e caktojnë vet. Ky mund të jetë mjek, mundësisht i të njëjtit specialitet të cilit i përket mjeku i paditur ose avokat i licencuar.
7. Kur Komisioni i Gjyimit Disiplinor i shkallës së parë, apo të dytë e cilëson të domosdoshme prezencën e palëve, atëherë ata janë të detyruar të jenë të pranishëm, pavarësisht pranisë së përfaqësuesit të tyre mjek apo avokat.
8. Juristi i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve kontrollon zbatimin dhe respektimin e kësaj Rregulloreje, jep udhëzime dhe merr masa për të rregulluar të metat e konstatuara, për probleme që e konsideron të nevojshme, informon Presidentin e Këshillit Kombëtar të U.M.SH.-së.
9. Kur çështja e ankimuar i është referuar organeve të drejtësisë, Urdhri i Mjekëve kryen të gjitha veprimet konform kësaj rregulloreje, duke krijuar të plotë dosjen e çështjes. Nga ky moment, pezullohet Veprimi Disiplinor për t’u vazhduar më tej pas marrjes së vendimit të formës së prerë nga organet e drejtësisë nëse çështja i relatohet Urdhrit të Mjekëve nga këto organe, dhe nëse ka arsye për të ndërmarrë një proces disiplinor të mëtejshëm.

Neni 4 **Pranimi i ankesave**

Urdhri pranon dhe shqyrton pa përjashtim ankesat dhe denoncimet të cilat vijnë nga:

- a. Pacientë, familjarë të tyre si dhe qytetarë të tjerë;
- b. Ministria e Shëndetësisë, si dhe institucione të tjera shëndetësore publike apo private;
- c. Institucione jo shëndetësore të administratës publike apo private;
- d. Anëtarë të Urdhrit të Mjekëve, si dhe të profesioneve të tjera të shëndetit;
- e. Organet e mass-medias.

Neni 5
Veprimi disiplinor për antarë të umsh-së shtetas të huaj

1. Mjekët shtetas të huaj të cilët ushtrojnë profesionin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i nenshtrohen gjyqimit disiplinor në përputhje me këtë Rregullore si të gjithë antarët e UMSH-së me shtetësi shqiptare. Në çdo rast ata janë të detyruar të paraqiten me përkthyesin e tyre.
2. Masa disiplinore e vendosur ndaj tyre i njoftohet organit homolog të vendit përkatës (Urdhrit, Dhomës apo Shoqatës).

PJESA E DYTË
KOMISIONET-EKIPET NDIHMËSE DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 6
KOMISIONET E GJYKIMIT DISIPLINOR

1. Pranë Këshillave Rajonale dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë Komisionet e Gjyqimit Disiplinor Profesional të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë:
2. Komisionet e Gjyqimit Disiplinor Profesional të shkallës së parë ngrihen pranë çdo Keshilli Rajonal dhe janë në funksion vetëm të këtij Këshilli. Këto komisione përbëhen nga 9 (nëntë) antarë prej të cilëve 7 (shtatë) mjekë dhe 2 (dy) juristë. Për çdo çështje në gjyqim vetëm 3 (tre) nga këta, 2 (dy) mjekë dhe 1 (një) jurist caktohen në përbërje të Komisionit të Gjyqimit Disiplinor Profesional.
3. Komisioni Kombëtar i Gjyqimit Disiplinor Profesional i shkallës së dytë ngrihet pranë Këshillit Kombëtar dhe është në funksion të këtij këshilli. Ky Komision përbëhet nga **15 (pesëmbëdhjetë)** antarë, prej të cilëve **13 (trembëdhjetë)** mjekë dhe 2 (dy) juristë. Për çdo çështje në gjyqim të shkallës së dytë, vetëm 5 (pesë) nga antarët e këtij komisioni, 4 (katër) mjekë dhe 1 (një) jurist, caktohen në përbërjen e Komisionit të Gjyqimit Disiplinor Profesional.

Neni 7
Përzgjedhja dhe emërimi i komisionerëve

1. Kandidatët për antarë të Komisioneve të Gjyqimit Disiplinor Profesional të shkallës së parë përzgjidhen nga Këshilli Rajonal dhe miratohet me vendim të këtij Këshilli.
2. Kandidatët për antarë të Komisionit Kombëtar të Gjyqimit Disiplinor Profesional të shkallës së dytë (Apeli) përzgjidhet nga Presidenti i Këshillit Kombëtar, dhe miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar.

3. Kandidatët juristë për anëtarë të Komisioneve të Gjyimit Disiplinor Profesional preferohet të përzgjidhen nga juristë (juristë të institucioneve shëndetësore ose avokatë të licencuar), të cilët kanë mbi 10 (dhjetë) vjet eksperiencë në punë.

4. Kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të të dyja shkallëve u merret paraprakisht miratimi dhe vetëm pasi ata të kenë rënë dakort, propozohen për vendim në këshillin përkatës .

Neni 8 **Kriteret e përzgjedhjes**

1. Kandidaturat për anëtarë të Komisioneve të Gjyimit Disiplinor Profesional përzgjidhen duke u orientuar nga këto kriteret:

- a. Përvojë jo më pak se 10 vjet në ushtrimin e profesionit;
- b. Prestigj dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;
- c. Mundësisht përvojë në veprimtari administrative;
- d. Ndalohen kategorikisht të zgjidhen në Komisionet e Gjyimit Disiplinor ata persona të cilët gjatë pesë viteve të fundit janë ndëshkuar me masa disiplinore, apo për çështje të tjera penale nga organet e drejtësisë;
- e. Ndalohet kategorikisht që në Komisionet e Gjyimit Disiplinor të zgjidhen persona që janë të emëruar në funksione drejtuese në administratën e institucioneve shtetërore apo në forume partiake të çfarëdo niveli.

Neni 9 **Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të komisionit të gjyimit disiplinor**

1. Mandati i anëtarit të Komisionit, në të dyja shkallët e gjyimit, është 5 (pesë) vjet, me të drejtën e riemërimit.

Neni 10

Lirimi i parakohshëm nga detyra e anëtarit të komisioneve të gjyimit disiplinor profesional

1. Lirimi i parakohshëm nga detyra e anëtarit të Komisionit bëhet kur :

- a. Paraqet kërkesë me shkrim për dorëheqje;
- b. Dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale ose kundravajtje administrativo-disiplinore ;
- c. Mungon tre herë, pa shkaqe të arsyetuara në seancat e gjyimit profesional ;
- d. Paaftësohet ose invalidizohet për arsye shëndetësore;

2. Largimi i parakohshëm dhe zëvendësimi bëhet me vendim të Këshillit Rajonal ose të Këshillit Kombëtar, përkatësisht për shkallën e parë dhe të dytë.

Neni 11
Ngritja e komisioneve disiplinore

1.Përbërja e Komisionit Disiplinor Profesional, si dhe Kryetari i Komisionit caktohet :

- a. Për shkallën e parë me vendim nga Presidenti i Këshilli Rajonal, në mungesë së tij zëvendësi;
- b. Për shkallën e dytë (Apeli) me vendim nga Presidenti i Këshillit Kombëtar, në mungesë së tij zëvendësi.

2.Kryetari i Komisionit (trupit gjykues) në të dyja shkallët e gjykimit është mjek.

Neni 12
Ndalimi për pjesëmarrje në komisionet disiplinore

1. Ndalohet pjesëmarrja në Gjykimet Disiplinore Profesionale, si dhe në ekipet ndihmëse e personave që kane lidhje gjinie, farefisi apo çfarëdo lidhje tjetër shoqërore a miqësore me personat në gjykim.

2. Mosdeklarimi i tyre sjell pezullimin e gjykimit dhe anulimin e vendimit kur gjykimi ka përfunduar. Ndaj personit merren masa dhe i vihen ngarkim shpenzimet e gjykimit.

Neni 13
Ekipet ndihmëse në proçesin disiplinor

1. Për çdo rast ankimimi apo denoncimi në funksion të proçesit disiplinor ngrihen ekipet ndihmëse me përbërje:

- a. Një mjek me detyrën e verifikusit/relatusit. Sipas rastit mund të jenë më shumë se një;
- b. Sekretar i Komisionit të Gjykimit Disiplinor;
- c. Ekspert mjekësor, mjeko-ligjor apo ligjor, një apo shumë sipas çështjes në gjykim;

Neni 14
Detyrat e verifikuesit/relatuesit dhe rradha e veprimeve në verifikimin paraprak

1. Relatuesi ka detyrë të bëjë verifikimin paraprak të saktë dhe objektiv të çështjes dhe të bëjë verifikimin e faktorëve nga disa burime. Për të përmbushur këtë detyrë, relatuesi kryen veprimet sipas kësaj rradhe:

- a.Takon mjekun e paditur të cilit i kërkon hollësira apo sqarimet nesë shihen të nevojshme;
- b. Nëse është e nevojshme, takon drejtusin e institucionit, ku punon mjeku i paditur;
- c. Merr kopje dokumentesh klinike, si dhe të tjera dokumente që lidhen me çështjen;

d.Merr dëshmitë e nevojshme nga mjekë e personeli tjetër mjekësor apo persona të tjerë, ku punon mjeku i paditur. Dëshmitë merren me shkrim dhe të firmosura nga personi i intervistuar.

e.Në përfundim të verifikimit paraprak, verifikuesi/relatuesi harton Raportin përfundimtar të verifikimit të çështjes, të cilën e firmos dhe ja dorëzon sekretarit të Këshillit Rajonal. Ky i fundit e protokollon dhe e inventarizon të numërtuar në Dosjen e çështjes.

2. Verifikimi paraprak përfundon jo më vonë se 30 ditë nga emërimi i relatorit.

Neni 15 **Masat disiplinore**

1. Kur sipas fakteve dhe provave të administruara në dosjen e çështjes, vërtetohet se anëtari ka kryer sjellje apo veprime të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, ligjit apo statutit të UMSH-së, Komisioni Disiplinor jep këto masa disiplinore:

a.Vërejtje me shkrim;

b.Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit,

c.Gjobë nga 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri në 100.000 (njëqindmijë) lekë.

d.Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucionet shëndetësore dhe private;

e.Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Mjekëve deri në 3 vjet;

f.Përrjashtim nga Urdhëri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet;

2. Përveç masave disiplinore të parashikuara në pikën 1 të këtij Neni, si masa plotësuese, Komisioni ka të drejtë t’ju caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese të barabarta me 20 (njëzet) kredite.

3. Masat disiplinore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mund të shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore si vijon:

a.brenda një viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b” të pikës të këtij neni.

b.brenda 3 vitesh nga dita e dhënies së tyre, për shkronjat “d”, “e” dhe “f” të pikës 1 të këtij neni.

4. Gjoha e vendosur sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij Neni derdhet në buxhetin e shtetit.

PJESA E TRETË
PROÇESET E GJYKIMIT DISIPLINOR

Neni 16
Gjykimi në shkallën e parë

1. Sekretari i Këshillit Rajonal krijon dhe administron me përgjegjësi Regjistrin e ankesave/denoncimeve, protokollin e tyre, si dhe dosjen e posaçme për çdo çështje disiplinore.
2. Për çdo ankesë/denoncim të mbërritur në Këshillin Rajonal fillohet proçesi disiplinor sipas kësaj radhe veprimesh:
3. Ankesa/denoncimi i mbërritur protokollohet, regjistrohet në regjistrin e posaçëm dhe inventarizohet e numratuar në Dosjen e çështjes.
4. Presidenti dhe sekretari i Këshillit Rajonal e thërrasin në zyrën e këshillit, mjekun e paditur të cilin e njohin me:
 - a. Ankesën e mbërritur ndaj tij dhe i dorëzojnë kopje të saj;
 - b. Proçedurat që kryhen për gjykimin disiplinor profesional;
 - c. Detyrimin që brenda 10 ditëve nga ky moment të paraqesë me shkrim mbrojtjen dhe argumente e dëshmi kundërthënëse për ankesën e paraqitur;
 - d. Të drejtën për t'u përfaqësuar e mbrojtur në gjykimin nga një mjek mundësisht i të njëjtit specialitet apo avokat i liçencuar;
 - e. Detyrimin për të qënë prezent në seancën dëgjimore apo kur komisioni i Gjyimit e cilëson të domosdoshme prezencën e tij.
5. Presidenti apo sekretari takojnë drejtuesin e institucionit shëndetësor publik apo privat për t'i njoftuar ankesën dhe për të bashkëpunuar për kryerjen e verifikimit paraprak dhe informacione të tjera.
6. Presidenti apo sekretari takojnë palën ankuese/denoncuese për të marrë informacion plotësues lidhur me pretendimet, synimet dhe gadishmërinë për t'u ballafaquar me palën tjetër. **Në këtë rast** kërkohet nëse:
 - a. I qëndron ose jo ankesës së bërë;
 - b. Ka ose jo dëshmitarë dhe materiale të tjera që provojnë çështjen e ankimuar;
7. Pala ankuese njihet gjithashtu me:
 - a. Proçedurën disiplinore;

b.Të drejtën për t'u përfaqësuar e mbrojtur nga një mjek mundësisht i të njëjtit specialitet me mjekun e paditur ose avokat i liçencuar;

c.Detyrimin për të qënë prezent në seancën dëgjimore apo kur komisioni i gjykimit e kërkon një gjë të tillë.

8. Bëhet ballafaqimi i palëve ndërgjyqëse, të cilat njihen me përmbajtjen e dosjes dhe nëse arsyetohet se çështja e ankimuar nuk është domethënëse për t'a kaluar domosdoshmërisht në proces gjykimi, i ofrohet dhe sugjerohet mundësia e pajtimit dhe mbyllja e çështjes. Nëse palët arrijnë mirëkuptimin për pajtim dhe çështja mbyllet, hartohet dokumenti i posaçëm për mbyllës, i cili firmoset nga palët ndërgjyqëse, si dhe Presidenti dhe Sekretari i Këshillit Rajonal.

9. Në rast mospajtimi Vendoset relatimi i çështjes për Gjykim Disiplinor të shkallës së parë ku:

a.Caktohet mjeku (apo mjekët) verifikues/relatues të cilit i bëhet e ditur detyra që do të kryej dhe rëndësia e saj duke i vënë në dispozicion për këtë qëllim kjo Rregullore.

b.Caktohen ekspertët mjekësor, mjeko-ligjor, ligjor në varësi të çështjes në gjykim, të cilëve iu parashtrihen kërkesat e pyetjet lidhur me çështjen që do të ekspertohet.

10. Caktohet përbërja e Komisionit Gjykimit Disiplinor Profesional dhe kryetari i tij.

Neni 17

Procedurat paraprake për gjykimin në shkallën e parë

1. Pasi caktohet mjeku (apo mjekët) verifikues/relatues të çështjes, si dhe caktohet Komisioni Gjykimit Disiplinor Profesional dhe kryetari i tij, i jepen detyrat mjekut (apo mjekëve) verifikues/relatues, i komunikohet edhe afatet për paraqitjen e Raportit mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes.

2. Sapo Raporti i Verifikimit Paraprak të Çështjes është zbardhur nga mjeku (apo mjekët) verifikues/relatues, i vihet në dispozicion së bashku me materialet që përmban dosja e çështjes Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional.

3. Nëse Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional e sheh të nevojshme marrjen e ekspertëve, ato thirren dhe pasi njihen me materialet e dosjes, brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional njofton datën për zhvillimin e seancës, të cilën sekretari i Këshillit Rajonal përkatës ia komunikon palëve ndërgjyqëse.

4. Sekretari i Këshillit Rajonal me dakordësin e Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional cakton datën e zhvillimit të këtij gjykimi, duke lajmëruar palët dhe personal e interesuar.

Neni 18
Zhvillimi i seancës së gjyimit të shkallës parë

1. Proçesi disiplinor i shkallës së parë të gjyimit organizohet dhe kryhet nën kujdesin e Presidentit dhe sekretarit të Këshillit Rajonal, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen deri në përfundim të tij.
2. Anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe të Ekipit Ndhmës lajmërohen për datën dhe orën e seancës dëgjimore dhe çështjen që do të gjykohet, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, para datës së caktuar për seancën dëgjimore. Gjatë këtyre ditëve në zyrën e Këshillit Rajonal ata njihen me raportin mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes dhe me materialet e dosjes në tërësi.
3. Verifikimi paraprak, si dhe Gjykimi Disiplinor i shkallës së parë, kryhen jo më vonë se 60 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës për gjykim.
4. Gjykimi Disiplinor Profesional shkallës së parë zhvillohet në 2 (dy) faza :
 - a. Faza e hapur;
 - b. Faza e mbyllur dhe vendimmarrja;

I. Faza e hapur, në të cilën Kyetari hap zyrtarisht seancën dëgjimore. Paralajmëron palët dhe të pranishmit të respektojnë rregullat për zhvillimin normal të seancës. Në të kundërt seanca ndërpritet dhe shkaktarit i vihen ngarkim shpenzimet e seancës. Pastaj, Kryetari vazhdon duke komunikuar shprehimisht se:

"Ankuesi/kërkuesi _____ ka paditur në Këshillin Rajonal të Qarkut _____ mjekun _____ për _____."

Në bazë e për zbatim të Ligjit Nr.123/2014, datë 25.09.2014 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" dhetë Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional, deklaroi të hapur seancën dëgjimore për Gjykim Disiplinor Profesional të çështjes së sipërpërmendur".

I.a. Në seancë sekretari i Këshillit Rajonal përkatës mban proçesverbalin, ku shënon pjesëmarrjen e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në seancë, si dhe paraqet të dhënat e dosjes, duke lexuar titullin e secilit dokument dhe duke ia bërë të dukshëm atë edhe palëve.

I.b. Seancën e drejton Kryetari i Komisionit të Gjyklimit Disiplinor Profesional, i cili fillimisht i jepet fjala mjekut (apo mjekëve) verifikues/relatues, të cilët lexojnë Raportin mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes.

I.c. I jepet fjala palës që ka paraqitur ankimin për të paraqitur edhe një herë ankesën/kërkesën e saj, si dhe nëse ka për të paraqitur apo dorëzuar dokumente të tjera në lidhje me çështjen, pastaj i jepet fjala palës së paditur, për të paraqitur prapësimet e saja në lidhje me ankesën, si dhe nëse ka për të paraqitur apo dorëzuar dokumente të tjera në lidhje me çështjen.

I.d.Kryetari i Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional pasi dëgjon palët, nëse e sheh të nevojshme kërkon detajime të mëtejshme nga palët ndërgjyqëse, si dhe në rast se e vlerëson të rastit bën ndërhyrje për zgjidhjen me mirëkuptim të ankesës së paraqitur.

I.e.Pastaj fjala u jepet fjala ekspertëve, në rast se janë thirrur të tillë.

I.f.Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit nëse kanë pyetje për palët në gjykim, për relatuesin, si dhe për ekspertët.

Nëse gjatë seancës lindin kërkesa për verifikime plotësuese, Komisioni vendos ndërprerjen e seancës duke e pasqyruar këtë në procesverbal, i cili firmoset nga anëtarët e komisionit dhe sekretari. Seanca tjetër detyrimisht zhvillohet brenda limitit kohor 60 ditor nga data e depozitimit të ankesës/denoncimit me shkrim në Këshillin Rajonal përkatës.

I.g.Para mbylljes së seancës, u jepet fjala palëve në gjykim, në fillim asaj të paditur, pastaj palës tjetër, nëse kanë kërkesa për sqarime dhe shpjegime të tjera.

I.h.Në përfundim, Kryetari i Komisionit pyet palën ankuese nëse dëshiron të vazhdojë gjykimin disiplinor profesional:

- Nëse pala ankuese, bie dakort për zgjidhjen me mirëkuptim apo heq dorë nga ankesa, ky fakt shënohet në procesverbalin e seancës dhe nënshkruhet si nga palët ndërgjyqëse, ashtu dhe nga Kryetari dhe sekretari.

- Nëse pala ankuese nuk bie dakort për zgjidhjen me mirëkuptim apo nuk heq dorë nga ankesa, ky fakt shënohet në procesverbalin e seancës, i cili nënshkruhet nga **Kryetari** dhe sekretari.

I.i.Në rastin e dytë, Kryetari i Komisionit i komunikon palëve kalimin e çështjes në fazën e dytë (Faza e mbyllur dhe vendimmarrja).

II. Faza e mbyllur dhe vendimmarrja, realizohet pa praninë e pjesëmarrësve në proces, dhe sekretari nxjerr jashtë ambientit, ku zhvillohet seanca pjesëmarrësit në proces.

II.a.Komisioni Gjyimit Disiplinor Profesional i shkallës së parë, në prani të sekretarit, vazhdon diskutimin pa praninë e personave të tjerë.

II.b.Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional të shprehin mendimin dhe të argumentojnë atë, për marrjen apo jo të masës ndëshkuese ndaj mjekut të paditur.

II.c.Pasi merret në konsideratë mendimet e anëtarëve të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional të shkallës së parë, Kryetari paraqet propozimin e tij, i cili hidhet në votim të hapur kundrejt propozimeve të tjera alternative. Mbetet në fuqi propozimi, që ka shumicën e thjeshtë të votave.

II.d.Plotësohet fleta e Vendimit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional, sipas formularit “B”, dhe administrohet në dosjen e çështjes.

II.e.Sekretari pasi i fton të pranishmit të rikthehen në ambient duke mbajtur qetësinë dhe të ngrihen në këmbë. Kryetari i Komisionit shpall vendimin.

II.f.Sekretari i Këshillit Rajonal përkatës së bashku me Juristin e Komisionit, duke u mbështetur në procesverbalin dhe në vendimin e marrë nga Komisioni Gjyimit Disiplinor Profesional, e zbardh vendimin në 3 (tre) kopje, të cili e firmosin, Anëtarët e Komisionit Disiplinor Profesional, si dhe Presidenti i Këshillit Rajonal përkatës dhe vuloset me vulën e Këshillit Rajonal përkatës.

II.g.Vendimi i zbardhur i dorëzohet palëve ndërgjyqëse nga sekretari i Këshillit Rajonal përkatës në formatin “C”, ku u komunikohet palëve se kundrejt këtij vendimi brenda 15 ditësh kalendarike mund të bëhet ankimim në Komisionin Disiplinor Kombëtar të shkallës së dytë (Apelit). Një kopje e vendimit mbahet në Këshillin Rajonal përkatës, si dhe nga një kopje u dorëzohet palëve ndërgjyqëse.

Neni 18

Gjykimi në shkallën e dytë (Apeli)

1. Proçesi i Gjyimit Disiplinor Profesional i shkallës së dytë (Apelit) kryhet nën kujdesin e Presidentit, Zv.Presidentit dhe juristit të Këshillit Kombëtar, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij proçesi.
2. Verifikimi paraprak, nëse kërkohen të dhëna të tjera shtesë, si dhe Gjykimi Disiplinor Profesional në shkallën e dytë (Apeli), kryhen jo më vonë se 60 ditë nga dita e mbërritjes së ankesës për apelimin ndaj vendimit.
3. Komisioni Kombëtar i Gjyimit Disiplinor Profesional i Apelit merr këto vendime:
 - a. Lë në fuqi vendimin e shkallës së parë;
 - b. Kthen çështjen për rigjykim në shkallën e parë;
 - c. Shqyrton çështjen dhe merr vendim për ndryshimin e vendimit;
4. Përveç rasteve kur çështja kthehet për rigjykim në shkallën e parë, të gjitha vendimet e tjera të gjyimit të shkallës së dytë (Apelit) janë përfundimtare dhe të formës së prerë. Vendimet që përmbajnë masë disiplinore ndaj mjekut (mjekëve), u komunikohet edhe institucioneve, ku ato ushtrojnë profesionin.
5. Vendimi i Komisionit Kombëtar (Apelit) mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e vendimit apo nga komunikimi i tij.

Neni 19

Veprimet për gjykimin në shkallën e dytë (Apeli)

1. Për çështjen e mbërritur në Apel njoftohet Presidenti i Këshillit Kombëtar, i cili kryhen procedurat për caktimin e Komisionit Gjykimin Disiplinor Profesional të shkallës së dytë, si dhe të relatuesit/verifikuesit, i cili mund të jetë relatori i mëparshëm.
2. Njoftohet njëkohësisht edhe pala e paditur, të cilës i jepet kopje e ankimit ndaj vendimit dhe i kërkohet të sjell brenda 10 ditëve kundër argumentat e veta me shkrim.
3. Dosja e Gjykimin Disiplinor Profesionale të shkallës së parë, së bashku me ankimin e depozituar i dorëzohet me procesverbal në Këshillin Kombëtar, i cili ia vë në dispozicion atë Komisionit të Gjykimin Disiplinor Profesional të Apelit.
4. Juristi i Këshillit Kombëtar pasi konsultohet me Komisionin e Gjykimin Disiplinor Profesional të Apelit, cakton ditën dhe orën e zhvillimit të seancës për të cilën njoftohen të gjithë pjesëmarrësit (anëtarët e komisionit, relatorin, palët ndërgjyqësore dhe ekspertët, nëse ka të tillë), jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para zhvillimit të saj.
5. Relatuesi, nëse është e nevojshme, ndërmerr veprime verifikuese plotësuese për probleme, që mund t'i kërkohen nga Komisioni i Gjykimin Disiplinor Profesional i Apelit apo ekspertët.
6. Këshillit Kombëtar nën kujdesin e zv. Presidentit dhe juristit merr masat për sallën dhe krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e gjykimin.

Neni 20

Mbledhja e komisionit për zhvillimin e gjykimin

1. Seanca e Gjykimin Disiplinor Profesional e Apelit pasqyrohet në procesverbal duke respektuar dhe zbatuar të njëjtat rregulla si në shkallën e parë të gjykimin dhe ndjek procedurën e mëposhtme:
 - 1.a.** Kryetari i Komisionit të Gjykimin Disiplinor Profesional të Apelit deklaron hapjen e seancës për gjykimin disiplinor profesional, në lidhje me çështjen kundër mjekut (mjekëve) " _____ " të paraqitur nga pala ankuese Z. _____, ndaj Vendimit Nr. _____, datë _____ të Këshillit Rajonal të Urdhrit të Mjekëve _____.
 - 1.b.** I jepet fjala Relatuesit, i cili lexon pretendimet e palës ankuese ndaj vendimit Nr. _____, datë _____, të Këshillit Rajonal të Urdhrit të Mjekëve _____.
 - 1.c.** I jepet fjala palës tjetër për të paraqitur kundërgargumentet e veta.
 - 1.d.** U jepet me rradhë fjala anëtarëve të Komisionit të Gjykimin Disiplinor Profesional të Apelit, për të kërkuar sqarime rreth çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykimin.

1.e.Nëse gjatë zhvillimit të seancës kërkohen verifikime plotësuese, apo ekspertizë, Komisioni Gjykimor Disiplinor Profesional i Apelit, vendos ndërprerjen e seancës dhe e pasqyron këtë në procesverbal, duke e firmosur të gjithë antarët e tij.

Për këtë veprim njoftohet Presidenti i Këshillit Kombëtar, i cili urdhëron kryerjen e veprimeve të mëtejshme. Pas kryerjes së verifikimeve plotësuese apo marrjes së mendimit të ekspertëve, seanca pasardhëse bëhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

1.f. Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipër **(1.e)**, u jepet fjala ekspertëve dhe specialistëve të ekipit ndihmës dhe menjëherë pas tyre Kryetari i Komisionit të Gjykimor Disiplinor Profesional të Apelit e deklaron të mbyllur seancën, për të marrë vendimin.

1.g.Të gjithë pjesëmarrësit në proces dalin jashtë ambientit, ku po zhvillohet gjykimi, dhe në ambient janë vetëm anëtarët e Komisionit të Gjykimor Disiplinor Profesional të Apelit dhe sekretari. Kryetari i Komisionit të Gjykimor Disiplinor Profesional i jep fjalën me radhë anëtarëve të komisionit, të cilët shfaqin mendimet dhe propozimet e tyre të argumentuara në lidhje me çështjen. Kryetari i Komisionit, duke marrë në konsideratë mendimet dhe argumentat e anëtarëve, bën komentet dhe propozimin e vet në lidhje me çështjen objekt gjykimi.

1.h.Propozimi i Kryetarit të Komisionit hidhet në votim të hapur përkundrejt propozimeve të tjera alternative. Mbetet në fuqi propozimi, që ka marrë shumicën e thjeshtë të votave, duke plotësuar procesverbalin e votimit sipas formularit **"B1"**, të cilën e nënshkruajnë Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Gjykimor Disiplinor Profesional të Apelit.

1.i.Sekretari i fton të palët ndërgjyqëse të rikthehen në ambientet, ku zhvillohet procesi, duke mbajtur qetësinë dhe të ngrihen në këmbë. Kryetari i Komisionit të Gjykimor Disiplinor Profesional të Apelit shpall vendimin.

1.j.Sekretari, i cili ka mbajtur procesverbalin e gjykimor të çështjes së bashku me juristin e komisionit, duke u mbështetur në procesverbalin dhe në vendimin e marrë nga Komisioni i Gjykimor Disiplinor Profesional i Apelit, e zbardh vendimin në 4 (katër) kopje, sipas formularit **"D"**, të cilin e firmosin Anëtarët e Komisionit të Gjykimor Disiplinor Profesional i Apelit, Presidenti i Këshillit Kombëtar dhe vuloset me vulën e Këshillit Kombëtar.

1.k.Një kopje e vendimit të zbardhur i dorëzohet palëve ndërgjyqëse, një kopje administrohet në arkivën e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe një kopje administrohet në dosje, e cila i dorëzohet sekretarit të Këshillit Rajonal përkatës.

1.l.Vendimi i Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, brenda afateve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

PJESA E KATËRT
Dispozita përfundimtare

Neni 21

Njoftim i institucioneve për vendimet e gjykitit disiplinor profesional

1. Vendimi i Gjykitit Disiplinor Profesional, i bëhet i ditur institucionit në të cilin ushtrojnë profesionin mjeku (mjekët).
2. Vendimi i Gjykitit Disiplinor Profesional, me të cilin merret masë disiplinore ndaj mjekut (apo mjekëve), në raste me interes të veçantë, i bëhet i ditur Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 22

Mungesa e pjesëmarrjes së palëve në gjykimin disiplinor profesional

1. Palët ndërgjyqëse kontaktohen nëpërmjet adresës së deklaruar nga ato vetë në ankesë apo në database të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.
2. Gjatë gjykitit disiplinor profesional, nëse njëra nga palët ndërgjyqëse mungon personalisht ose/dhe as nuk përfaqësohet në seancën dëgjimore nga personi i autorizuar, për arsye të justifikuara, seanca shtyhet duke u caktuar një datë tjetër, e cila i komunikohet palëve.
3. Gjatë fazës së parë të Gjykitit Disiplinor Profesional të shkallës së parë, mungesa e pajustificuar e palëve ndërgjyqëse, sjell si pasojë shtyrjen e zhvillimit të seancës dhe caktimin e një date tjetër, e cila i komunikohet palëve ndërgjyqëse.
4. Nëse pala ankuese, mungesa e të cilës ka sjell shtyrjen e seancës së parashikuar në paragrafin e mësipërm (3), mungon përsëri për shkaqe të pajustificuara, gjykimi disiplinor i çështjes së paraqitur nga pala ankuese pushohet, duke konsideruar mosparaqitjen e palës si tërheqje nga kërkesa/denoncimi i depozituar.
5. Nëse pala e paditur, mungesë e të cilës ka sjell shtyrjen e seancës së parashikuar në paragrafin e mësipërm (3), mungon përsëri për shkaqe të pajustificuara, gjykimi disiplinor vazhdon në mungesë.
6. Gjatë Gjykitit Disiplinor Profesional të Apelit, nëse njëra apo të dyja palët ndërgjyqëse mungojnë pa arsye të justifikuara, gjykimi disiplinor profesional shtyhet për një tjetër datë, e cila nuk duhet të jetë më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e seancës së pazhvilluar. Në rast të përsëritjes së mungesës së palës apo palëve, gjykimi disiplinor profesional vazhdon në mungesë, dhe komisioni i Gjykitit Disiplinor Profesional i Apelit mund t'i vendosë në ngarkim shpenzimet e këtij gjykimi.

Neni23

Pjesëmarrja në seancë dhe komunikimi me median

1. Për pjesëmarrjen e të ftuarve dhe të publikut në seancat e gjyqimit disiplinor profesional, vendoset për çdo rast në mënyrë të veçantë nga Komisioni i Gjyqimit Disiplinor Profesional përkatës, duke marrë parasysh ruajtjen dhe moscënimin e privatësisë për të dyja palët ndërgjyqjese.
2. Ndalohet dhënja e informacionit për mediat para së të shpallet vendimi përfundimtar nga Komisioni i Gjyqimit Disiplinor Profesional i Apelit.

Neni24

Shpërblimi i pjesëmarrjes në proceset disiplinore

1. Anëtarët e Komisioneve të Gjyqimit Disiplinor Profesional, sekretarët, si dhe ekipet ndihmëse në procese disiplinore shpërblehen me honorare nga U.M.SH.-ja, sipas mënyrës dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.
2. Kur dërgohen me shërbime jashtë rrethit, ata përfitojnë shpenzime udhëtimi e dieta, sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin të Këshillit të Ministrave përkatës në fuqi.

Neni25

HYRJA NE FUQI

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit me vendim nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

PRESIDENTI

Dr. Fatmir BRAHIMAJ

Miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 08.04.2016, ndryshuar me Vendimin Nr. 8, datë 08.07.2016 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë